



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT VINCENZO DEL MONACO,  
NË 30-VJETORIN E GJYKATËS KUSHTETUESE**

*20 tetor 2022*

*Shkëlqesia Juaj Presidenti i Republikës së Shqipërisë,  
Zonja Kryetare e Kuvendit,  
Zonja Kryetare e Gjykatës Kushtetuese,  
Kolegë, Shkëlqesi,  
Të ftuar të shquar,  
Zonja dhe Zotërinj!*

Është nder i veçantë për OSBE-në dhe për mua të kemi privilegjin t'ju drejtohem në këtë ditë të jashtëzakonshme kur Gjykata Kushtetuese feston Jubileun e 30-të. Çdo qytetar shqiptar feston sot këtë perlë që është Gjykata Kushtetuese e tyre. Prania sot e Shkëlqesive Tuaja, SH.T.Z. President të Republikës, së bashku me institucionet më të larta të vendit, dëshmon rëndësinë dhe domethënien e kësaj dite, frymën e unitetit dhe kohezionit kombëtar në mbështetje të punës së gjyqtarëve të kësaj Gjykate.

Është vërtetë e jashtëzakonshme.

Dy vite më parë, Shqipëria kishte një Gjykatë Kushtetuese të paralizuar nga mungesa e kuorumit. Sot, Gjykata është plotësisht funksionale dhe vepron në mënyrë të rrjedhshme e të efektshme e udhëhequr nga njohuritë më të mira të pjesëtarëve të saj, nga përkushtimi i tyre, me mbështetjen e plotë të institucioneve të tjera të vendit, drejtuesve politikë, ku të gjithë frymëzohen nga Kushtetuta. Ky është fakt që meriton të theksohet dhe të kremtohet.

Për OSBE-në, Gjykata Kushtetuese luan rol thelbësor. Rol kulmor në demokracinë shqiptare. Për rëndësinë e së Drejtës, për “communauté de droit” kombëtare, shprehje kjo që do e dëgjoni mjaft shpesh në të ardhmen me fuqizimin e mëtejshëm të procesit të pranimit në BE. Rol kyç për rritjen e besimit të qytetarëve tek institucionet, e respektit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve, duke dhënë arsyetimin përfundimtar të ndikimit të drejtpërdrejtë të dispozitave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Thënë thjesht, Gjykata Kushtetuese ka kontribut madhor për rrënjosjen e besimit të qytetarëve me ndërgjegje për vlerat e përbashkëta. Atyre vlerave që janë të përbashkëta për të gjithë; vlerave që janë të prekshme për qytetarët, që kështu kanë qenë edhe para se të hidheshin në letër. OSBE-ja e përgëzon këtë frymë përkatësie, këtë përbashkim ndaj Kushtetutës, sepse ndihmon përmirësimin e besimit me themel të Shqipëria, duke projektuar qëndrueshmëri dhe siguri si brenda edhe jashtë vendit.

Për OSBE-në, kjo veprimtari ka edhe një kuptim tjetër. Ajo transmeton siguri për së jashtmi duke treguar se çfarë bën Shqipëria posaçërisht në fushën e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ajo portretizon një imazh të vërtetë të Shqipërisë, ku një yjësi institucionesh, organesh të pavarura, si shigjeta të stivuara e të bëra gati për të njëjtin hark, të cilat së bashku përbëjnë fuqinë drejt një objektivit të vetëm: fuqizimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës.

Sa e trishtë që në pjesë të tjera të planetit tonë, të drejtat e njeriut frikshëm respektohen më pak sot krahasuar me më parë. Vende ku demokracia, barazia dhe drejtësia mbeten vlera të mohuara në mënyrë flagrante, pavarësisht se lartësohen në mënyrë teatrale. Vende ku fiktivja zëvendëson lajmin dhe propaganda zëvendëson të vërtetën.

Më lejoni ta mbyll duke theksuar përsëri respektin që kam për Gjykatën Kushtetuese dhe për gjyqtarët e saj, si të mëparshmit edhe të tanishmit, duke nisur nga Kryetarja, Vitore Tushe, me të cilën kam pasur privilegjin të bashkëpunoj nga afër dhe prej të cilës kam mësuar më shumë nga ç'mund të dijë ajo.

Faleminderit shumë!

**Fund**